

BASHKIA LEZHE

Nr. _____ Prot.
____/____ 2019

Lezhë, më

FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT

Data : 04.07.2019

Për: Uleza Ndertim shpk Tirane

Procedura e prokurimit: I hapur me mjete elektronike

Numri i referencës së procedurës/lotit: REF-21383-05-09-2019

Përshkrim i shkurtër i kontratës: Rikonstrukcion i shkolles se Mesme te Bashkuar , “Ishull Lezhe “ dhe ndertim palestre

Fondi limit : Fondi limit : 67 642 272 (gjashtedhjetë e shtatë milion e gjashtëqind e dyzet e dy mijë e dyqind e shtatë dhjetë e dy leke vëne në dispozicion nga buxheti i shtetit dhe bashkia Lezhe me bashkefinancim 50% me 50%

Me vendimin nr 2 date 27.03.2019 “Per shperndarjen e financimit per projektet e reja , thirrja e pare per vitin 2019 , Grantet “ Arsimi baze” , Arsimi i Mesem “ te Komitetit per zhvillimin e rajoneve , bashkise Lezhe i eshte miratuar fondi prej 81 170 727 nga te cilat 50% te projektit do te financohen nga Buxheti i Shetit , Granti per arsimin dhe 50% e fondit do te financohet nga bashkia Lezhe

Vlera e plote e bashkefinancimit nga FZHR eshte **33 821 137** pa perfshire vleften e TVSH-se

Vlera e plote e bashkefinancimit nga bashkia Lezhe **33 821 136** pa perfshire vleftene tvsh-se

Vlera e financimit nga FZHR per vitin 2019 eshte **11 839 898** leke pa perfshire vleftene tvsh-se

Vlera e bashkefinancimit e bashkise Lezhe per vitin 2019 eshte **16.910.568** leke leke pa perfshire vleftene tvsh-se .Diferenca shtrihet per likujdim ne vitin 2020

Afati i perfundimit te punimeve: 9 muaj nga dt e dorezimit te sheshit te ndertimit

Publikime të mëparshme (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: çmimi më i ulët X oferta ekonomikisht më e favorshme

Njoftojme se, kane qenë pjesëmarrës në procedurë këta ofertues me vlerat përkatëse të ofruara:

- Agri Construction me nr. nipti K 01725001F me vlere oferte 67 314 933 (gjashtedhjetë e shtatë milion e treqind e katërmbëdhjetë mijë e nentëqind e tridhjetë e tre) leke
- Elda –VL me nr.nipt K67106202W nuk ka paraqitur asnje lloj dokumentacioni
- Shendelli me nr. nipt K07924803N me vlere oferte 54 455 930 (pesëdhjetë e katër milion e katërqind e pesëdhjetë e pesë mijë nentëqind e tridhjetë leke

- Uleza Ndertim me nr nipti J67902928O me vlere oferte 66 853 765 (gjashtedhjetë e gjashtë milion e teteqind e pesëdhjetë e tre mijë e shtateqind e gjashtedhjetë e pese) leke

Janë skualifikuar ofertuesit e mëposhtëm:

-Elda – VL shpk nuk ka paraqitur asnjë lloj dokumentacioni në përmbushje të kriterëve të vecanta kualifikuese

KVO vendosi të refuzojë operatorin ekonomik Elda-VL shpk

-Agri Construction shpk

Pas shqyrtimit të dokumentacionit të paraqitur KVO konstatoi se :

-Nuk ka paraqitur shtojcë mbi disponiminë mjeteve dhe nuk ka paraqitur asnjë dokumentacion justifikues për makineritë e kerkuara në shtojcën nr 10

-nuk ka paraqitur asnjë lloj dokumentacioni në plotësim të kriterit të kerkuar në pikën 6 “Operatori ekonomik duhet të plotësojë dhe të dorëzojë së bashku me dokumentet e tjera, një deklaratë ku të deklarojë furnizuesin të paktën për parketin , bojrat, llacet për suvatim. Bashkëngjitur deklaratës duhet të paraqitet : - Certifikata FSC e parketit dhe skeda teknike që tregojnë përputhjen me standartin EN-13226 , - Certifikatat ISO 9001-2015 dhe 14001-2015 për bojrat dhe llacet .”

- nuk ka paraqitur asnjë lloj dokumentacioni për kriterin e kerkuar në pikën 4 germa b “Operatori ekonomik duhet të ketë të punësuar personel teknik të kualifikuar, i domosdoshëm për kryerjen e punimeve si më poshtë:

tre teknik ndertimi; një teknik mekanik, një teknik elektrik; tre instalues elektrik; dy hidraulike; dy saldatore; tre karpentier: tre murator -suvaues.

Punonjësit e mësipërm duhet të kenë një eksperiencë minimumi 5 vjetare të certifikuar (certifikuar para 5 viteve) të vërtetuar me diplome shkolle se mesme për teknikët dhe dëshmi kualifikimi profesional/ diploma/certifikata të shkolle profesionale përkatëse për secilin specialitet të lëshuar nga institucione të licensuara nga organet përkatëse sipas legjislativës për shkollat profesionale dhe të figurojnë në listat e shoqërisë për të paktën për periudhën janar 2018-mars 2019.

Përveç dokumentave të mësipërm për një teknik elektrik dhe për një instalues elektrik të paraqitet dhe dëshmi e sigurimit teknik lëshuar nga ISHTI ose institucione ekuivalente sipas ligjit Nr 8734 datë 01.02.2011.”

-Nuk plotëson kriterin e kerkuar në germenin d “Operatori ekonomik të ketë në stafin e tij të paktën 6 (gjashtë) punonjës të certifikuar për "Punime në lartësi", ku minimumi i njeri të jetë inxhinier. Personat e mësipërm të kenë një eksperiencë të certifikuar minimumi tre vjetare , të vërtetuar kjo me certifikatën përkatëse të lëshuar nga institucione të akredituara dhe të figurojnë në listat e shoqërisë për të paktën për periudhën janar 2018-mars 2019.” Ka paraqitur dokumentacion vetëm për një nga drejtuesit teknik ing . Edmond Xhuveli

- mungon grafiku I punimeve

Komisioni i vlerësimit të ofertave mbështetur në nenin 46, pika 1 germa “b” të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, ku parashikohet shprehimisht se: “Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa

kohë që ato janë në përpjestim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohen dhe jodiskriminuese. b) aftësia teknike: operatorët ekonomikë vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës;” si dhe në nenin 53, pika 3 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, ku parashikohet: “Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet

Per sa me siper oferta e dorezuar nga subjekti Agri Construction shpk refuzohet .

3.Shendelli shpk

Pas shqyrtimit te dokumentacionit te paraqitur nga shendelli shpk KVO konstatoi se ky operator nuk permbush te gjitha kriteret e vecanta kualifikuese te kerkuara ne DST . Konkretisht:

1.Dokumentat e paraqitura per pjesen kryesore te stafit teknik ne permbushjete pikes 4.b te kriterëve te vecana jane paraqitur vetem me vule te noterit te pashoqeruara me dokumentin noterial njehsim me origjinalin ,per pasoje jane te pavlefshme.

2.Nuk ka provuar se disponon 3 (tre) teknike ndertimi. Ka paraqitur dokumentacion te sakte vetem per nje teknik ndertimi. Per tekniket e tjere mungon vertetimi i njesisë me origjinalin te deshmise se kualifikimit.

3.Nuk ka paraqitur dokumentacion per 1 teknik mekanik. Mungon vertetimi i njesisë me origjinalin te deshmise se kualifikimit.

4.Nuk ka paraqitu rdokumentacion per 1 hidraulik. Per hidrauliket e tjere mungon vertetimi i njesisë me origjinalin te deshmise se kualifikimit.

5.Nuk ka paraqitur dokumentacion per 2 instalues elektrik. Per elektrikistet e tjere mungon vertetimi I njesisë me origjinalin te deshmise se kualifikimit.

6.Nuk ka paraqitur dkumentacionin e kerkuar per **3 karpentier**. Ne DST Eshte kerkuar“ duhet te kene nje eksperience minimumi 5 vjecare te certifikuar (certifikuar para 5 viteve) te vërtetuar me diplome shkolles se mesme per tekniket dhe dëshmi kualifikimi profesionale/ diploma/certifikata te shkolles profesionale përkatëse per secilin specialitet te leshuar nga instuticione te licensuara nga organet perkatese sipas legjislacionit per shkollat profesionale dhe te figurojne ne listpagesat e shoqërisë për të paktën per periudhen janar 2018-mars 2019. . Ne plotesim te ketij kriteri Shendelli shpk ka paraqitur vetem deshmi te sigurimit teknik . Deshmite e sigurimit teknik nuk mund te konsiderohen deshmi profesionale kualifikimi mbeshetur ne legjislacionin e arsimimit profesional si dhe ne interpretimet e KPP-se.

7.Nuk ka paraqitur dokumentacionine kerkuar per **3 muratore suvatues**. Deshmite e sigurimit teknik nuk mund te konsiderohen deshmi profesionale kualifikimi. mbeshetur ne legjislacionin e arsimimit profesional si dhe ne interpretimet e KPP-se.

8.Nuk ploteson kriterin e experiences 3vjecare te certifikuar per 3(tre) punonjes per punime ne lartesi.

9.Nuk ka paraqitur deklarate per furnizuesin e parketit, bojaravedhellaceve per suvatim., si dhe certifikatat ISO 9001-2015 dhe 14001-2015 per bojrat dhe llacet.

Nuk ka paraqitur certifikaten FSC te parketit dhe shkedenteknike qe tregon perputhjen me standartin EN-13226

10.Pas verifikimit te pasqyrave financiare rezulton se nuk ka paraqitur Inventarin e mjeteve te konfirmuar nga tatimet, kriter ky i kerkuar ne piken 7 germa e " Te gjitha mjetet e transportit dhe pajisjet e mesiperme ne pronesi (pika 1 - 17) duhet te jene detyrimisht te pasqyruara ne Inventarin e Mjeteve te vitit 2018 te konfirmuar nga administrata tatimore.

11.Ka paraqitur deklarim jo te vertete per gjenerator 2 cope ne pronesi. E ka deklaruar ne shtojce por mbeshtetur ne Inventarin e vitit 2018 (te paraqitur) nuk e disponon kete pajisje.

12.Ka paraqitur deklarim jo te vertete per Vinc kulle ne pronesi. E ka deklaruar ne shtojce por mbeshtetur ne Inventarin e vitit 2018 (te paraqitur) nuk e disponon kete pajisje.

13.Nuk disponon vinc karrel sipas shtojces dhe po keshtu te deklaruar ne inventarin e mjeteve. Sipas inventarit te mjeteve nuk disponon keto lloj pajisjeje.

14.Nuk disponon pajisje per hekurthyes (tranxhe/elektrobango) sipas shtojces dhe po keshtu ne inventarin e mjeteve te deklaruar.

15.Nuk disponon kokore, fikse zjarri, prozhektore ndricimi, tabela paralajmeruese. sipas shtojces dhe po keshtu ne inventarin e mjeteve te deklaruar.

16.Nuk disponon 3 kamiona veteshkarkues mbi 35 ton.

Komisioni i vleresimit te ofertave mbeshtetur ne nenin 46, pika 1 germa "b" te ligjit nr. 9643, date 20.11.2006 "Per prokurimin publik", i ndryshuar, ku parashikohet shprehimisht se: "Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjestim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohen dhe jodiskriminuese. b) aftësia teknike: operatorët ekonomikë vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës;" si dhe ne në nenin 53, pika 3 të ligjit nr. 9643, date 20.11.2006 "Per prokurimin publik", i ndryshuar, ku parashikohet: "Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet

Per sa me siper KVO vendosi te refuzoje oferten e paraqitur nga Shendelli shpk

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë Uleza Ndertim me nr nipti J679029280 me vlere oferte 66 853 765 (gjashtedhjetë e gjashtë milion e teteqind e pesedhjetë e tre mijë e shtateqind e gjashtedhjetë e pese) leke është identifikuar si oferta e suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë *[bashkise Lezhe , sektorit te prokurimeve publike]* sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda 5 (pese)ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi.

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, do të konfiskohet sigurimi i ofertës suaj (nëse është kërkuar) dhe kontrata do t'i akordohet ofertuesit vijues në klasifikimin përfundimtar, oferta e të cilit është dorëzuar me një vlerë të përgjithshme prej *[vlera përkatëse e shprehur në fjalë dhe shifra]*, siç parashikohet në nenin 58 të Ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë : 26.06.2019

Ankesa: ka ose jo: Nuk ka

(nëse ka) ka marrë përgjigje në datë _____

**KRYETARI
FRAN FRROKAJ**